



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

U D H Ë Z I M

Nr. _____, datë _____.____.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË DOKUMENTACIONIT TË
DETYRUESHËM QË RUHET NGA LOBISTI, MËNYRËS SË
ADMINISTRIMIT DHE AFATEVE TË RUAJTJES SË TIJ**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

U D H Ë Z O N:

1. Ky udhëzim rregullon kategoritë e dokumentacionit që lobisti është i detyruar të ruajë, mënyrën e administrimit të tij dhe afatet e ruajtjes në zbatim të nenit 17 të Ligjit.
2. Lobisti i regjistruar në Regjistrin e Lobimit është i detyruar të ruajë dokumentacionin që lidhet me veprimtarinë e lobimit, si më poshtë:
 - a) dokumentacionin e paraqitur pranë Komisionerit për regjistrimin, deklarin dhe raportimin e veprimtarisë së lobimit, duke përfshirë formularët përkatës, deklaratat periodike dhe çdo ndryshim të deklaruar;
 - b) kontratat e lobimit dhe çdo ndryshim të tyre;
 - c) dokumentacionin financiar që lidhet me veprimtarinë e lobimit, duke përfshirë dokumentet që provojnë pagesat, shpenzimet dhe transaksionet financiare;
 - d) dokumentacionin që lidhet me përmbushjen e detyrimeve për shmangien e konfliktit të interesit, sipas Ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
 - e) komunikimet me shkrim që lidhen me zbatimin e kontratës së lobimit, përfshirë komunikimet e dërguara dhe të marra nëpërmjet çdo forme ose platforme të komunikimit elektronik.
3. Dokumentacioni i parashikuar në pikën 2 të këtij udhëzimi administrohet në formë fizike ose elektronike, duke garantuar integritetin, autenticitetin dhe disponueshmërinë e tij gjatë gjithë afatit të ruajtjes.
4. Lobisti ruan dokumentacionin e parashikuar në pikën 2 të këtij udhëzimi për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet. Afati i ruajtjes fillon nga data në të cilën dokumenti është hartuar, nënshkruar, lëshuar, miratuar ose ka prodhuar efekt, sipas natyrës dhe mënyrës së krijimit të dokumentit përkatës.
5. Gjatë kësaj periudhe, lobisti është i detyruar ta vendosë dokumentacionin në dispozicion të Komisionerit, me kërkesën e tij.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet struktura përgjegjëse pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi